

TERMA REFERENCE

REDAKTIM RAPORTI

Pozicioni / Shërbim	Ekspert i jashtëm për redaktim raporti
Titulli i Projektit	“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”
Mbështetur:	Projekti financohet nga Ambasada Britanike në Shqipëri
Lloji i Kontratës :	Kontratë shërbimi – ekspert për redaktim raporti
Periudha e kontratës	Mars 2024
Ditë pune	9 ditë pune

Informacion i përgjithshëm për Projektin

- Projekti ka për qëllim të kontribuojë në parandalimin dhe shfaqjen e ndikimeve të panevojshme përmes angazhimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit, si dhe përmes informimit të një grupi të rëndësishëm të aktorëve dhe palëve të interesuara për të siguruar implementimin e drejtë dhe të lirë nga ndikimet e panevojshme në procesin zgjedhor.
- Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

Qëllimi i shërbimit

Në kuadër të implementimit të “*Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike*”, Instituti i Studimeve Politike kërkon ekspert të jashtëm për redaktim raporti.

Për zbatimin e projektit, eksperti do të jetë përgjegjës për:

- Redaktimin e raportit në gjuhën shqipe;
- Redaktimin e strukturës së materialit me fokus kritikën dhe sugjerimet;
- Kontrollin e referencave, footnotes dhe shënimet fundore të materialit;
- Të ofrojë vërejtje dhe sugjerime;
- Të bashkëpunojë ngushtësisht me ekspertin/ autorin e raportit;
- Të bashkëpunojë ngushtësisht me drejtuesin e projektit;
- Të mundësojë dorëzimin e timesheet-eve, duke raportuar mbi orët e shërbimit të realizuara në përputhje me qëllimin e shërbimit të kërkuar, apo çdo dokument shoqërues që do të duhet për raportimin e shërbimit;
- Gatishmëri për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e kërkuar sipas afatit kohor të përcaktuar;
- Mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të shërbimit.

Profili i ekspertit:

- Eksperiencë të mëparshme në fushën e redaktimit/ editimit të raporteve;
- Njohës i legjislacionit të zgjedhjeve dhe praktikave të Dekriminalizimit;
- Shumë i/e organizuar në nivel detyre dhe projekti;

Aftësitë individuale:

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të jetë shumë i vëmendshëm ndaj detajeve;
3. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip dhe jo vetëm;
4. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afatet e vendosura.

Dokumentet e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dorëzojnë:

1. CV e detajuar;
2. Ofertë Financiare (ditë pune/GBP);
3. Punë ngjashme të realizuara më parë nga kandidati.

Aplikimi duhet të dërgohet në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 18.02.2024 ora 16:00

1. **Në formë elektronike** në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com,
2. **Me postë** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*ISP - Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike – ekspert i jashtëm për redaktim*”

INSTITUTI I
STUDIMEVE POLITIKE



INSTITUTE FOR
POLITICAL STUDIES

raporti. Të mos hapet përpara datës së tenderit.”, në adresën: Rr “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

3. **Dorazi** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*ISP_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike - ekspert i jashtëm për redaktim raporti. Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

(Lutemi specifikoni qartë e-mail ose një nr. kontakti.)

Instituti i Studimeve Politike